



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Nr. ____ Prot

Dokument parlamentar

Tiranë, 18.07. 2018

RAPORT

**PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE CASSA DEPOSITI E PRESTITI
S.P.A., PËR PROGRAMIN E ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL
NËPËRMJET INOVACIONIT” , PROPOZIM I KËSHIT TË MINISTRAVE**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e tij të datës 18.07.2018, në mbështetje të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.* për programin e arsimit dhe formimit profesional “.

Komisioni , pasi u njoh me përmbajtjen e projektligjit, diskutoi rreth tij dhe vlerësoi se:

Projektligji i paraqitur nga Këshilli i Ministrave është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenet 81,100 dhe 121 të saj.

Kjo marrëveshje është në vijim të marrëveshjes qeveritare dypalëshe për programin në fjalë, ratifikuar me ligjin nr.51/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për programin “në mbështetje të arsimit dhe formimit (AFP) nëpërmjet inovacionit”.

Kjo marrëveshje për akordimin e një huaje të butë, në vlerën 5 milionë euro është në vijim të përmbushjes së vizionit të përcaktuar dhe në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi

(SKPA) 2014-2020, në sektorët prodhues, ku Shqipëria ka një potencial të madh dhe Italia ka një vlerë të shtuar të konsiderueshme.

Përmes kësaj marrëveshje priten përfitime të ndjeshme në organizimin dhe zhvillimin e Shkollës Bujqësore multifunktionale të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Fier dhe përmirësimin e riorganizimit të shkollës së AFP-së në Lushnjë.

Njëkohësisht do zhvillohet dhe aplikimi i kurrikulave të AFP-së, të cilat orientohen nga tregu.

Këtij qëllim i shërben dhe ndërtimi i mardhënieve multifunktionale të AFP-së dhe sektorit privat.

Ky financim në një trevë me kushte tejte të favorshme gjeomorfologjike për zhvillimin e bujqësisë, veterinarisë, mekanikës bujqësore etj, në shkollat me orientim profesional rrit ndjeshëm përmirësimet në infrastrukturë dhe tregues të tjerë të vijueshmërisë së mësimit dhe do ndikojë në rritjen e efikasitetit, në organizimin dhe modernizimin e tërë parametrave që kërkojnë për shkolla cilësore, bashkëkohore në sistemin e arsimit dhe formimit profesional.

Këtij qëllimi do i shërbejnë ndërhyrjet fizike dhe jo fizike në rehabilitimin e infrastrukturës, pajisjeve me laboratorë, asistencë institucionale teknike, asistencë për ministrinë e linjës.

Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të kurrikulave të AFP-së, të orientuara nga tregu i punës.

Përmes këtij programi do të ndërhyhet në tri nivelet e ofertës AFP në Shkollën e Ekselencës, me qëllim që të adresohen boshllëqet e identifikuar në lidhje me aftësitë në sektorin e bujqësisë dhe atë të përpunimit agro-ushqimor.

Me interes është futja në kuadrin e system *dual* (të dyfishtë) funksional, lidhjet e qendrës shumëfunktionale me sektorin privat, veçanërisht në bujqësi dhe në sektorin e përpunimit agro – ushqimor.

Në funksion të ngritjes cilësore të këtyre shkollave do jenë grantet dhe skemat e mikrokredive për të rinjtë sipërmarrës bujqësorë që i ofrojnë shkollës autoritetet shqiptare, skemat e shërbimit kombëtar të punësimit, si dhe trajnimet ndërkombëtare dhe asistencë teknike për AFP nga ndërmarrjet italiane , gjetje pune, binjakëzim me shkolla të tjera të AFP, shkëmbim të praktikave më të mira etj.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është maksimizimi i përputhshmërisë me financimin e IPA II për to në sektorin e punësimit dhe aftësive.

Programi do të mbështetet në të njëjtët tregues si te dekumenti i veprimit të BE-së për sektorin social, të punësimit dhe aftësive lidhur me objektivat e përgjithshme dhe ato të veçanta.

Në përfundim, Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit vendosi me shumicë votash miratimin e tij në parim , nen për nen dhe në tërësi dhe e përcjell për miratim në séance plenare.

RELATOR

Bujar ÇELA

ZV/KRYETARE

Milva EKONOMI